



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.120..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 / 08 / 2023

VENDIM

Nr. 28, date 30 / 08 / 2023

PËR

PROJEKT IDENË E OBJEKTIT

“RIKONSTRUKSIONI I DIGËS SË REZERVUARIT TË PEZE GJYSLIKONE”, TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.08.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane për Rikonstruksionin e Diges së Rezervuarit të Peze Gjyslikone e cila administrohet nga kjo Bashki.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente ZENITH & Co shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se **projekti nuk ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit të mesiperm si dhe të nenit 8 të VKM së mesipërme**. Raportet mbështetëse për studimet Sizmike, gjeologjike dhe gjeoteknike nuk janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 15.02.2021.

Gjithashtu, projekti nuk ka marrë në konsideratë asnjë prej kërkesave të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 35, datë 12.10.2021 si llogaritjet e vales vërsuese në rastet e prurjeve maksimale dhe në rastet e prishjes së diges, studimin në lidhje me jetëgjatësinë e diges dhe ujëmbledhësit të saj, hartimin e planit të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile, etj. Përfaqësuesit e firmës konsulente sqaruan se nuk ishin të informuar nga Bashkia Tirane në lidhje me këtë Vendim si dhe me projektin e miratuar nga KKDM përmes Vendimit të mesiperm. Projekti i paraqitur nga firma konsulente parashikonte edhe disa punime në trupin e diges që duhej të ishin zbatuar gjatë punimeve të miratuara në projektin e mëparshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Tirane për punimet e kryera deri më sot në zbatim të projektit të miratuar nga KKDM rezultoi se punimet për zbatimin e projektit të mëparshëm dhe akti I kolaudimit të këtyre punimeve jo vetëm që nuk janë miratuar nga KKDM por rezultoi se ka ndryshime të projektit të miratuar nga KKDM të cilat nuk janë paraqitur në KKDM sipas legjislacionit në fuqi si dhe disa problematika në lidhje me sasinë dhe cilësinë e punimeve për të cilat KKDM është shprehur në detaje në Vendimin Nr. 26, datë 30.08.2023

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratojnë këtë Projekt Idene e paraqitur për shkak të mungesave të paraqitura me siper dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratojnë Projekt Idene për Rikonstruksionin e Diges së Rezervuarit të Peze Gjyslikone për shkak të mosplotësimin të kërkesave të legjislacionit në fuqi, mungesive të konstatuara në studimet mbështetëse për ceshtjet e Sizmikes, gjeologjise dhe gjeoteknikes si dhe problematikave të konstatuara në zbatimin e punimeve të projektit të mëparshëm të miratuar me vendimin e KKDM Nr. 35, datë 12.10.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

2- Ti kërkoj Bashkisë Tirane

- Te plotesoj kërkesat e shprehura ne Vendimin e KKDM Nr. 35, date 12.10.2021 dhe dorezimin e nje raporti te posacem ne lidhje me plotesimin e ketyre kërkesave brenda muajit Nendor 2023. Raporti duhet te shoqerohet me llogaritjet e kerkuara per qendrueshmerine e diges, llogaritjet e vales vershuese ne ratset e prurjeve maksimale qe ndodhin nje here ne 100 vjet si dhe ne rastin e prishjes se mundshme te diges, studimin per jetegjatesine e kesaj dige dhe efektivitetin e saj ne lidhje me qellimin kryesor pe rte cilen eshte pregatitur. Raporti duhet te perfshij Planin e gadishmerise per emergjencat civile (PGEC) sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi dhe udhezimeve te dhena ne Vendimin e KKDM Nr. 5, date 16.11.2020 "Per hartimin e Planeve te gadishmerise ne rastet e emergjencave civile". PGEC duhet te permbaje llogaritjet per perhapjen e vales duke dhene kohen, siperfaqen, shpejtesine dhe thellesine e kesaj vale ne zonen poshte diges, harten e permbytjes se zones poshte diges te bazuar ne zhvillimin aktual urban te kesaj zone, skenaret e mundshem te emergjencave.
- Te rishikoj studimet mbeshtetese per Sizmiken, Gjeologjine dhe Gjeotekniken e zones ne perputhje me kushtet aktuale dhe udhezimeve te KKDM te shprehura ne Vendimin Nr. 15, date 15.02.2021.
- Te kryeje verifikimin e sasise dhe cilesise se punimeve te zbatuara per projektin e miratuar nga KKDM me vendimin Nr. 35, date 12.10.2021 dhe pas shqyrtimit te dokumentacionit te zbatimit te ketyre punimeve, te qartesoj dhe te shprehet ne lidhje me domosdoshmerine dhe efektivitetin e nje projekti te ri per rikonstruksin e kesaj dige.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

